



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmjeno / Prodato Received / Delivery	10.05.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAMBAC	4168/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.574/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.574/2023 të datës 28.03.2023, të parashtruar nga ankuesi [] nga [] kundër Vendimit me numër protokolli 280 të datës 14.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Fushë Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.574/2023 e datës 28.03.2023, e parashtruar nga ankuesi []
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokolli 280 i datës 14.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Fushë Kosovës dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.
- III. Obligohet Komisioni Disiplinor i Komunës së Fushë Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- III. Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [] (me tej vetëm ankuesi), nëpunës civil në Komunën e Fushë Kosovës, më datë 28.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 280 të datës 14.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Fushë Kosovës, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 24.04.2023, ka përcjell vetëm shkresat lidhur me çështjen.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3049/2023 të datës 28.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 280 të datës 14.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Fushë Kosovës; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore të datës 14.02.2023; Njoftim për seancë të Komisionit Disiplinor i datës 16.02.2023; Përgjigjen për seancën e procedurës disiplinore nga ankuesi me datë 21.02.2023 për Kryetarin e Komisionit Disiplinor; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin i datës 24.01.2023; Listën e pushimit vjetor për ankuesin nga SIMBNJ; Kërkesën për takim fillestar e datës 01.06.2022; Procesverbali i takimit hyrës i datës 03.06.2022; Emailin e datës 07.06.2022 nga A.S për ankuesin; Emailin e datës 06.06.2022 nga ankuesi për A.S; Kërkesë për takim fillestar të datës 30.01.2022; Procesverbal i takimit hyrës i datës 15.02.2023; Plani Vjetor i datës 22.12.2022 për Njësinë e Auditimit të Brendshëm; Plani Strategjik për Njësinë e Auditimit të Brendshëm për periudhë 2023-2025 i datës 22.12.2022; Raportin Vjetor të Punës dhe Aktiviteteve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022; Emailin e datës 20.02.2023 nga ankuesi për F.K dhe të tjetër ; Emailin e datës 16.02.2023 nga ankuesi për F.K dhe të tjerët; Emailin e datës 13.02.2023 nga ankuesi për V.G; Emailin e datës 13.02.2023 nga ankuesi për B.B; Emailin e datës 03.02.2023 nga ankuesi për V.H dhe të tjerët; Emailin e datës 31.01.2023 nga ankuesi për M.K; Emailin e datës 15.02.2023 nga ankuesi për V.G, M.S dhe B.H; Emailin e datës 13.02.2023 nga D.M për B.B; Raporti i Auditimit për Komunën e Fushë Kosovës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.04.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 3779/2023; Akt Emërimit me numër protokollit 730 i datës 07.07.2016; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 24.02.2023; Kërkesë për prova shtesë e datës 28.04.2022 nga A.B për H.Gj; Përgjigjen në kërkesë për prova shtesë e datës 04.05.2023 nga H.Gj për A.B; Raportin e vijueshmërisë për ankuesin për periudhën nga data 01.01.2022 deri 31.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, ka konstatuar që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i Komunës së Fushë Kosovës, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit me numër protokollit 730 të datës 07.07.2016, ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm.*

Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, më datë 14.02.2023 ka parashtruar pranë Komisionit Disiplinor kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, për shkak të pretendimeve për kryerje të shkeljeve të rënda sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni Disiplinor më Vendimin më numër protokollit 280, të datës 14.03.2023, ka shpallur përgjegjëse ankuesin për shkelje të rënda të detyrave të punës sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.9 si dhe nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë duke i shqiptuar masat disiplinore *"ndalim për 20% në pagë për periudhën pesë mujore dhe pezullimin e përkohshëm të auditimit për periudhën dhjetë mujore"*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 280 të datës 14.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Fushë Kosovës, pretendon se Komisioni Disiplinor i Komunës së Fushë Kosovës në mënyrë të pa drejtë dhe pa konstatim të gjendjes faktike ka bërë shqiptimin e masës disiplinore si dhe duke shkelur procedurat ligjore në fuqi.

Ne kuptim të bazueshemrisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë lidhur me procedurën disiplinore të nëpunësve civilw, përkatësisht sysh:

Nenit 45 ka përcaktuar se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*.

Nenit 46 ku citohet se: *1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta... ndërsa "Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë"*.

Nenit 47 ka përcaktuar se: *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"*.

Andaj, referuar kuadrit ligjor si me lart, Kolegji ka analizuar vendimin e kontestuar dhe si rrjedhojë ka konstatuar së arsytimi i të njëjtit nuk përmban shpjegim të situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi dhe cilat shkaqet kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor me vendimin e kundërshtuar më ankesë nuk ka saktësuar së cilat veprime apo mosveprime e bëjnë përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore dhe cilat dokumente-informata janë publikuar nga ankuesi pa dijeni të mbikëqyrësit të tij të drejtpërdrejtë, e që përbejnë shkelje të detyrave të punës, kështu që mbi bazën e këtyre fakteve Kolegji konstaton se Vendimi me numër protokoll 280 i datës 14.03.2023 është nxjerrë në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"1. Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsytimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim"*.

Kolegji i Këshillit po ashtu ka gjetur së kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit ishte bërë mbi bazën e mos raportimit të ankuesit të Kryetari i Komunës, mungesës së komunikimit, vijueshmërisë në punë, nxjerrjen e dokumentacionit jashtë pa autorizim të Kryetarit të Komunës, mos analizimi e çështjeve paraprakisht me menaxhmentin e drejtpërdrejt, tejkalim të kompetencave dhe procesimi i dokumenteve mbështetur në bindjet politike e pa shtjellim të lëndëve, ndërsa nga analizimi i vendimit të kundërshtuar rezultoi se Komisioni Disiplinor nuk ka shqyrtuar dhe vendosur për të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore gjegjësisht Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar dhe vendosur vetëm për pretendimin e vijueshmërisë në punë dhe shpalesjes së dokumenteve pa miratim të Kryetarit të Komunës, kështu që mbi këtë bazë rrjedhë detyrimi i Komisionit Disiplinor që në rishqyrtim të vendos për çdo pretendim veç e veç të kërkesës për iniciim të procedurës disiplinore të datës 14.02.2023.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Fushë Kosovës me Vendimin me numër protokollit 280 të datës 14.03.2023 ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "ndalim për 20% në pagë për periudhën pesë mujore dhe pezullimin e përkohshëm të Auditimit për periudhën dhjetë mujore", rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor mund të shqiptoj vetëm masat disiplinore të përcaktuara me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe së masa pezullim i përkohshëm nuk është përcaktuar si masë disiplinore, andaj një veprim i tillë bie ndesh me nenin 48 paragrafi 3 dhe nenin 50 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Duke qenë se vendimi i kontestuar me ankesë përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisionit Disiplinor i Komunës së Fushë Kosovës, me detyrimin që i njëjti në riprocedurë të eliminoj shkeljet e konstatuara sipas këtij vendimi dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Theksuar si me sipër, Kolegji duke vepruar sipas të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.574/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Komisionit Disiplinor të Komunës së Fushë Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Fushë Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;